

ARBEN SHEHI
KOHË PËR ASKUND
POEZI

BOTIMET TOENA

ARBEN SHEHI

Kohë për askund

poezi

Botimi i dytë

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2014

Botimi i parë: *Onufri*, 2009

Botimi i dytë: *Toena*, 2014

Botuese: Irena Toçi

Redaktor: Arben Iliazi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: A. Shehi - “Kohë për askund” (pastel)

ISBN 978-99943-1-953-4

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me çdo mjet apo formë, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollësja”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

*... në mënyrë që drita të ndriçojë
sa më shkëlqyeshëm,
errësira duhet të jetë e pranishme...*

FRANCIS BACON

Kohë për askund

LIRIA QË VJEN PREJ POEZISË

Si rrallëherë kur jam marrë me shënimet për një libër, kam pasur një kënaqësi të veçantë në rastin e librit në fjalë të Arben Shehit. Madje, madje jam ndier i privilegjuar. Kjo jo vetëm prej faktit se ndofta Arben Shehi përbën një nga njerëzit më të kultivuar në kryeqytetin tonë, por nga mënyra se si ai e përjeton krejt letërsinë, se si e krijon artin e tij dhe, veçanërisht, nga mënyra se si ai e shpall atë.

Me një modesti të natyrshme ai kalon thujtë pa u vënë re në rrugët e mjedisit të kryeqytetit, me atë këmbëngulje të brendshme që të mundet të mos tërheqë vëmendjen e pakkujt që s'ë njeh. Ndonëse është një nga njerëzit që ka udhëtuar më shumë, kudo nëpër botë, me mundësinë për të vizituar vende dhe personalitete të spikatura, pakkush ka pasur rastin të dëgjojë diçka të plotë për këtë eksperiencë. Ky njeri me muzikalitet të brendshëm të rrallë, me ndjeshmëri gati skajore, me një finesë të lëmuar deri në detajet më të holla, me sa duket e ka zgjedhur për mënyrë të jetës dëshirën për ta pasur jehonën e plotësisë së tij përgjithësisht brenda vetvetes.

Nuk ka trokitur thujtë kurrë nëpër redaksi gazetash, rrallëherë ka marrë pjesë në aktivitete zyrtare të poezisë. Por edhe kur kjo ka ndodhur, ai i ka refuzuar modestisht me heshtje. Kjo s'ka qenë aspak për kurrfarë kompleksi. Aq më tepër që për një periudhë mbi 10-vjeçare ka qenë një person

publik mjaft i njohur e i kërkuar. Thjesht ai ka vazhduar të jetojë midis profesionit (arkitektit), artit (pikturës) dhe poezisë. “Konglomerat artistik” e pata quajtur unë dikur në një promovim të librit të tij më 1996 - “Rikthim drejt gjërave që i kam dashur”. Ai qeshi atëherë me mua, por kurrë nuk më pengoi të shkruaja apo shpreheshja për të, qoftë edhe kur kam thënë se është, pa dyshim, një nga poetët më të ndjeshëm të lirizmit shqiptar. Ndërkaq ka vazhduar të shkruajë kudo dhe kurdo ku ka mundur dhe ka pasur kohë: në pauza konferencash, në cepa programesh zyrtare, prapa kartëvizitave të shumta, në bileta avioni, ngado në udhëtimet nëpër botë. E ndofta kjo përbën një arsye më tepër që, gjithsesi, poezia e tij ka një frymë të thellë lirie, një frymë dhe gjeografi sa kombëtare, aq edhe të përbotshme.

Në të njëjtën kohë krenar dhe i realizuar në erudicionin e tij (falë një tradite të vjetër familjare), ai është plotësisht një njeri i lirë. Sa më shumë shkallë lirie ka mbërritur, aq më tepër është përpjekur ta konservojë me këmbëngulje fanatike këtë pasuri të papërsëritshme. Kështu thotë ai kur bisedon me të. “Nëse asgjë personale njeriu nuk merr me vete në tjetërsimin e tij të përtejme, liria është shoqëruesja jote. Jeton dhe vdes me të. Një thesar i rrallë, që nuk vendoset në një ditë, as në një vit, por në një jetë të tërë. Është diçka që krijohet me një këmbëngulje të mbinatyrshe dhe vjen nga një burim i mbinatyrshtëm.” Për të ky burim është poezia. “Kam filluar të ndihem njeri i lirë qëkur fillova të frekuentoj poezinë, fillimisht të të tjerëve, dhe më pas të krijoj atë personale. Dhe, sa më shumë rrugë që kam bërë me të, aq më shumë është rritur ajo. Poezia është rrugëtimi im i vazhdueshëm drejt lirisë”, të thotë ai më një krenari të veçantë. Zëri i plotë burrëror dridhet pak në këtë moment, por ai e përligj atë. “Liria është drithëruese, është një peshë e madhe, më e larta, më sublimja, që nëse e arrin je më pranë perëndive. Është një Olimp”, thotë në fund dhe buzëqesh lirshëm. Pastaj hesht

gjatë duke vështruar kopertinën e librit të tij më të fundit, që ta zgjat me gëzimin e një fëmije kur të tregon rrobat e reja. Nuk ka dëshirë për fjalë të tepërta, ngaqë vetë flet pak. Dëshiron të dëgjojë më shumë. Por edhe kur të dëgjon me sytë e ndritshëm, pak indiferentë, mund të të krijohet përshtypja e një grimce ironie apo gati mospërfilljeje. Edhe mund të jetë ashtu. Por jo për bashkëbiseduesin, por ndaj vetes.

“... *Njeriu mendon se ia vlen, ndoshta kur arrin të mos pëlqejë vetveten...*”, e kam dëgjuar të thotë një herë.

Duke hedhur këto shënime kam menduar se nëse shprehja e njohur “... *poezia, sidoqoftë, është një pasqyrë e vogël e vetë poetit...*”, ka pjesë të së vërtetës, kjo është, pa dyshim, e vërtetë edhe për Arben Shehin. Një poezi thellësisht lirike e plot kontraste, një pasqyrim i plotë i lirisë, si dimension i tij më i qenësishëm. Krenar deri në skajshmëri dhe njëherësh modest, i përmbajtur dhe impulsiv, mik ekstremisht bujar, por edhe mermer i ftohtë, mirënjohës i lindur, por dhe harresëdhës i madh, fin deri në detajet më të vogla dhe gjithashtu gati arrakat, mondan tradite, por befasisht i thjeshtë deri në lodhje, stoik i lindur, por sakaq i gatshëm të përlozet si fëmijë... Mbase, mbase këto janë tiparet më të spikatura plot kontraste e kundërshti të karakterit të tij që, sigurisht, i janë skalitur në të gjithë krijimtarinë nëpër vite.

Kompleks në poezinë e tij, ai ka preferuar përherë të shkruajë një poezi krejt lirike, të shtrirë në kohë dhe në tematikë, në të cilat mbizotëron trinomi: vendlindja-familja-jeta. Brillant si ndofta pak kush, ai e quan nënën “*bukuria praruese*”, e krahason me perëndinë e bukurisë, duke e kthyer përjetësisht në një monument të gjallë që, gjithsesi, merr frymë edhe kur s’do të jetë më. Me një dashuri të përjetshme e përshkruan qytetin e tij, “Shkodrën e Mbretërve”, ndonëse me atë trishtimin poetik, për shumëçka nuk është ashtu siç ai do ta donte. Besoj se me një finesë magjike ai i ka dhënë

një dimension krejtësisht të prekshëm mallit, ndofta një nga dukuritë më të veçanta të shpirtit njerëzor. Malli tek Arben Shehi është i pranishëm gjithkund. Ai ka krijuar kështu shprehjen më njerëzore “malli më merr”, duke treguar se vërtetë ka mall për gjithçka njerëzore që frymon ose jo: për pikëllimin, për zogjtë dhe për qiejt e vjeshtës, për dashurinë e një kohe, për çatitë e pranverës, për qelqet e dritareve që tringëlljnë gati të krisin nga pritja dhe malli... Megjithëse ka shumë shi dhe vjeshtë ne poezinë e tij, kjo se ka penguar shfaqjen e diellit, sepse, sikurse lexohet kudo nëpër vargjet e tij, ai kurrë se ka kuptuar shkëlqimin e diellit pa praninë e errësirës, mallin pa trishtimin, gëzimin pa humbjen. Një ndërthurje e mrekullueshme kjo e kundërshtive të jetës në poezitë e krejt librit.

Duke përfunduar do të thosha se një risi në poezinë e Arben Shehit është raporti i tij poetik me vdekjen. Për herë të parë kemi një dukuri që ndoshta nuk është trajtuar kurrë më parë. Ai e sjell natyrshëm “vdekjen” në poezinë e tij, i buzëqesh, e çmitizon atë, dhe e kthen nga një ikonë mitike në një moment emocional të jetës, siç është edhe vetë ajo, në më shumë përkujdesje dhe përlotje malli për hapat e praruara të së bijës në largësinë e saj brenda botës gjithë dritë... Arben Shehi ëndërron të mbetet poet, mik i të gjithëve, i zogjve dhe i shiut, i trishtimit dhe i mallit, i shpresës dhe i ëndrrës, sikurse thotë edhe vetë në poezinë e mrekullueshme “E shkruar vetëm për time bije”: “... *mes duarve të tua mbushur me frymëmarrjen time të fundit...*”. Një testament unikal prindi dhe poeti gjithashtu.

Dhe, me sa duket, qoftë edhe vetëm për këto që thashë më sipër, jam ndier i privilegjuar që pata mundësinë të shkruaj këto radhë për Arben Shehin. Prandaj, ndoshta është një privilegj të jesh mik i artit, letërsisë dhe i vetë Arben Shehit.

ARBEN ILIAZI
Tiranë, shtator 2008

*Shkodrës, qytetit që u lind nga
liria e murosur e një Gruaje,
të tradhtuar nga të vetët...*

Prolog

.....

*Më ka rritur ky ajër.
Kur frynte egër murrhani
dhe shpesh më është dashur
të kërkoj hapat e pranverës
që s'di pse vonohej
lart, nëpër humbellat veriore...*

***BARI
I SHTËPISË SIME...***

BARI I SHTËPISË SIME

Po derdhet prapë qumështi i bardhë hënor
mbi konturin e vetmuar të mbrëmjes.
Fëmijë të vonuar
kthehen në rrugën e shtëpisë tërë heshtje.
Vendosin gazin e tyre si cirka yjesh përmbi fijet e barit,
duke lënë portën të hapur si një gojë memece...

Pllaq-plluq lëvizin plloçat e rruginës gjithë dhimbje.
Nuk ka rënë shi, po bari është rritur ndërkohës,
i zbehtë dhe i lodhur nga mungesa e hapave të mi.

.....

Më ka rritur ky ajër. Kur frynte egër murrilani
dhe shpesh më është dashur
të kërkoj hapat e pranverës që s'di pse vonohej
lart, nëpër humbellat veriore.

Megjithatë,
jam ndier mbret në këto shkallë, nën këto çati,

me çerdhe pëllumbash që i ndërtonim vetë,
dhe i ruanim po vetë.

Kurrë s'kam grisur faqe librash, shtëpi kukullash të motrës sime,
vizatime qiejsh me dritë mëngjesi dhe rrugë pa kufij
që i ëndërronim, po kurrë s'i pamë.

Si mjegullime të bardha me petkun e ëndrrave
shfaqeshin Çudi, Sheh Shamia, Mjeda, Dash Shkreli...
Dukeshin dhe iknin flurorë sakaq. Larg në magjinë e poezisë
dhe të lustrave që i kishin fituar, por dafinat s'ua dhanë kurrë,
vetëm e vetëm se qenë prej këtij Qyteti...

Është rritur ndërkaq bari i shtëpisë sime. I gjatë dhe memec.

Shkodër, prill 2005

e para

.....

*Të jetosh
për pak dritë...*

*Drita,
kurrkënd
më shumë se ty nuk deshi...*

***LIRIA
E DRITËS***

PROFIL NJERIU

Ajër...
ajër për të jetuar.

Ajër për të fluturuar,
ajër për të frymuar,
ajër për të shkuar larg...

Dhe gjithçka vetëm për një Vdekje.

Tiranë, 2003

QIRIRIT

Kurrkush më shumë se ti
dritën nuk e deshi.

Hidhërimi e dhimbja,
gëzimi e dashuria
brenda teje ishin...

Të jetosh
për pak dritë...

Drita,
kurrkënd më shumë se ty nuk deshi...

2003

ETERNE

Edhe ne do të vdesim...
Kjo nuk është pak.

Jetë të tjera presin radhën pas nesh.

Në fillim ishte fjala...
Dhe kjo nuk është pak.

NJË FRYMË LARG

Një frymë larg, në veri
është Kosova.

.....

Ka pyje dhe poetë që vuajnë shumë.

Një frymë larg Kosovën
e kemi...

1990

e dyta

.....

*Më kot mendon se do të gjesh prehje.
Është shumë e vogël kjo botë
për ëndrrën tënde...*

***RADHA
E KIJTESËS***

VETËMOTIV

Më kot mendon se do të gjesh prehje.
Është shumë e vogël kjo botë për ëndrrën tënde.
Breg më breg si lumi
përplasat dallga e qiellit mbi një kreshtë vjeshte
dhe shkon të mbytet në det.

Bie një mjegull fillikate si gjethe nëntori.
Rrëzohen shirat,
ylberet, pasditet, në zgrip të dhimbjes tënde.
Po karafila të kuq çelin e vyshken në buzëqeshje fëmijësh...

Përse më ke bërë kështu, o Zot?
Mbushur me brengë, trishtim, shpresë...

Më kot mendon se do të gjesh prehje.
Është shumë e vogël kjo ëndërr për botën tënde.

Sepse ti ke mbetur poet...

2002

E MEGJITHATË...

Gjithnjë më ke thënë se kam pasur diçka prej detit,
aty ku zanafillin dallgët, vetëtimat, stuhia...
Isha mësuar me dashurinë tënde, si me lindjen e diellit
nga një copëz blu prej qiellit të mëngjesit.

Në muzg nxitoja të thërrisja shirat.

(Ka pasur aq shumë shira në ditët tona,
ëndrra me ylbere pas mjegullave,
por, megjithatë, dhe kohë të bukur pas tyre pati.)

Gjithnjë më ke thënë se kam diçka prej detit.
Përplasem breg më breg, po gjumi kurrë s'më zë.

E megjithatë, e megjithatë...

2002

STREHËS SIME

Për të jetoj.

Përpiqem...

përditë e përditë.

Dhe s'mundem i pasur të mos ndihem.

Strehëz,

e ëmbla strehëz!

2002

